
	<p>Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo</p> <p>Komuna e Prishtinës Opština Priština – Municipality of Prishtina</p> <p style="color: blue; font-style: italic;">01-1124</p>	
---	--	---

Në bazë të nenit 21 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor Nr. 04/L-174 dt. 23.08.2013, nenit 18 të Ligjit për Ndërtim Nr. 04/L-110 dt. 31.05.2012, nenit 21, 22, 44 dhe 45 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Nr. 05/L-03 dt.21.06.2016, nenit 17, pika “d” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, Udhëzimit Administrativ të MMPH-së Nr.06/2017 dt. 23.05.2017 për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve, dhe në bazë të kërkesës, 05 nr. 350/02 – 0167059/18 dt.11.07.2018, të bashkëpronarëve, Jeton Nallbani, Edmond dhe Adnan Cërvadiku dhe pronarit Halit Maloku, të gjithë nga Prishtina, rr. “Perandori Dioklecian” p.n., për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektin kryesor për ndërtimin e kompleksit me ndërtesa shumë banesore & afariste – Lam. “01” & “02”, në kuadër të parcelave ndërtimore, “Grupi – faza 1” dhe “Grupi – faza 2” të Bllokut urban “T20”, të Planit Rregullues “Tophane” në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë administrative, me datë 17.10.2018, merr këtë:

V E N D I M
PËR CAKTIMIN E KUSHTEVE NDËRTIMORE

I. I caktohen kushtet ndërtimore bashkëpronarëve, Jeton Nallbani, Edmond dhe Adnan Cërvadiku dhe pronarit, Halit Maloku, të gjithë nga Prishtina, rr. “Perandori Dioklecian” p.n., sipas kërkesës, 05 nr. 350/02 – 0167059/18 dt.11.07.2018, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektin kryesor për ndërtimin e kompleksit me ndërtesa shumë banesore & afariste – Lam. “01” & “02”, në kuadër të parcelave ndërtimore, “Grupi – faza 1” dhe “Grupi – faza 2” të Bllokut urban “T20”, të Planit Rregullues “Tophane” në Prishtinë, konkretisht në kompleksin të parcelave kadastrale, nr.10087-1, 5876-0 dhe 5879-0 ZK Prishtinë, me trajtim edhe të sipërfaqes ndërtimore të parcelës kadastrale, nr.10087-2 ZK Prishtinë.

II. Lokacioni për të cilin caktohen kushtet ndërtimore përfshihet në kuadër të Planit Rregullues “Tophane” në Prishtinë, miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës 01nr. 35-579 dt. 22.11.2005, me destinim “Zonë me destinim të përzier”, plotësuar me Vendimin për plotësimin dhe mënyrën e realizimit të Planit Rregullues Urban “Tophane” 01 nr. 35–374 dt. 03.04.2008, si dhe në Planin Zhvillimor Urban, miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës, 01 nr. 035-181427 dt. 24.09.2013, me destinim “Ndërtim i lartë”.

Për kriteret, parametrat urban dhe kushtet e ndërtimit, kërkuesit janë informuar përmes “Informatë mbi kushtet e lokacionit të zgjidhjes urbane-arkitektonike të ngastrave kadastale nr.5880,5881 dhe 5882 në kuadër të Blloku “T20” nga Plani Rregullativ “Tophane”, 05nr.350 – 14203 dt.13.06.2008, Lejes urbanistike 05nr.350-14203/1 dt.08.08.2008 dhe përmes faqes zyrtare të internetit të Komunës së Prishtinës, ku janë të publikuara dokumentet e planifikimit hapësinor, konkretisht planet rregullues urbane, PZHK, PZHU, etj.

III. Gjendja ekzistuese e lokacionit / parcelave, sipas gjendjes kadastrale, faktike dhe dokumenteve të planifikimit hapësinor, është:

- Numri, sipërfaqja, pronari dhe klasa e kualitetit të parcelave është:

-nr.10087-1;	S=1240m ² ;	Edmond & Adnan Cërvadiku, Jeton Nallbani;	”tokë ndërtimore”;
-nr. 5876-0;	S=269m ² ;	Halit Maloku;	”tokë ndërtimore”;
-nr. 5879-0;	S=346m ² ;	Halit Maloku;	”tokë ndërtimore”;
<u>Totali : S=1855m²</u>			
-nr.10087-2;	S=152m ² ;	P.SH. KK Prishtinë;	”tokë ndërtimore”.

- Parcelat, nr.10087-1, 5876-0 dhe 5879-0 ZK Prishtinë, janë në pronësi të pronarëve privat, gjegjësisht e drejta pronësoro - juridike është private - tokë e ndërtuar, me kyçje në infrastrukturë teknike rrugë, ujësjellës, kanalizim, elektrikë dhe telefoni, kurse parcela nr.10087-2 ZK Prishtinë, ka kaluar në pronësi / posedim të P.SH. KK Prishtinë;
- Parcela nr.10087-2 ZK Prishtinë, është shpronësuar në procedurat paraprake bazuar në "Marrëveshje" 010nr.465-143723 dt.23.06.2014, në mes të Komunës së Prishtinës dhe Jeton Nallbani, Adnan dhe Edmond Cërvadiku, me sipërfaqe ndërtimi, $S=152 \times 4.0=608m^2$;
- Në kuadër të parcelës nr. 5876-0 shtrihen ndërtesat individuale banimore & afariste, me etazhitet P+1 dhe B+P+2, kurse në parcelën, nr.5879-0 shtrihen ndërtesat individuale banimore, me etazhitet P+0 dhe P+1, kurse në kuadër të parcelës, nr.10087-1 është hapur gropa ndërtimore, dhe është realizuar sigurimi i saj;
- Terreni i lokacionit, është kryesisht i rrafshët;
- Në diametër prej 50m' të lokacionit, përfshihen kryesisht ndërtesa individuale banimore, si dhe një ndërtesë shumë banesore dhe afariste;
- Parcelat kadastrale të lartcekura, kanë qasje nga rr. "Josip Rela" dhe rr. "Perandori Dioklecian";
- Me Leje urbanistike 05nr.350-14203/1 dt.08.08.2008, kjo drejtori ka caktuar kushtet e ndërtimit për parcelat kadastrale nr.5880, 5881 dhe 5882 ZK Prishtinë;
- Me Vendim 05nr.351-181443 dt.04.09.2014, nga kjo drejtori është lejuar ndërtimi i "Objekti 2" me etazhitet -2B+P+8, në kuadër të parcelës nr.10087-0 ZK Prishtinë;
- Me Konkluzion 05nr.070 – 102181 dt.14.05.2015, nga kjo drejtori është pezulluar vendimi i lejes ndërtimore 05nr.351 – 181443 dt.04.09.2014, për "Objekti 2", me etazhitet -2B+P+8;
- Me Aktvendim 05nr.035 – 130626 dt.03.06.2014, nga kjo drejtori është lejuar rrënimi i objektit ekzistues;
- Me Vendim 05nr.351/02-0173662/17 dt.24.10.2017, nga kjo drejtori është lejuar ndërtimi i "Objekti 2", me etazhitet -2B+P+6, në kuadër të parcelës nr.10087-1 ZK Prishtinë;

IV. Plani i situacionit – "zgjidhja urbane" e kompleksit me ndërtesa shumë banesore & afariste – Lam."01", "02" & "03", e analizuar, studiuar dhe trajtuar me kushte ndërtimore, është konceptuar në tri grupe - faza të realizimit, me trajtim të pjesëve dhe parcelave kadastrale, nr.10087-1, 5879-0, 5876-0, 5872-0, 5873-0, 5874-0, 5875-0 dhe 5877-0 ZK Prishtinë dhe nr.10087-2 ZK Prishtinë, e shpronësuar me sipërfaqe ndërtimore, si në vijim:

a) "Grupi - faza 1" e realizimit në kuadër të parcelës ndërtimore të konceptuar në bllokun urban "T20" të planit rregullues, për ndërtimin e kompleksit me ndërtesë shumë banesore & afariste – Lam. "01", me trajtimin e pjesëve dhe parcelave kadastrale, nr.10087-1 dhe 5879-0 ZK Prishtinë, me pronarë, Adnan dhe Edmond Cërvadiku, Jeton Nallbani dhe Halit Maloku nga Prishtina.

Sipërfaqja e parcelës ndërtimore trajtuar në këtë grup / fazë, brenda vijës rregulluese, është $S=878m^2$, dhe jashtë vijës rregulluese, $S=152 m^2$, sipas Planit të situacionit – "zgjidhjes urbane". Pjesa jashtë vijës rregulluese, me "Marrëveshje" 010nr.465-143723 dt.23.06.2014, është shpronësuar me sipërfaqe ndërtimore;

b) "Grupi - faza 2" e realizimit në kuadër të parcelës ndërtimore të konceptuar në bllokun urban "T20" të planit rregullues, për ndërtimin e kompleksit me ndërtesë shumë banesore & afariste – Lam. "02", me trajtimin e pjesëve dhe parcelave, nr.10087-1,5879-0 dhe 5876-0 ZK Prishtinë, me pronar, Adnan dhe Edmond Cërvadiku, Jeton Nallbani dhe Halit Maloku nga Prishtina. Në këtë parcelë ndërtimore, sipas bllokut urban të planit rregullues, shtrihet edhe pjesa e parcelës nr.7714-0 ZK Prishtinë, me pronar / posedues P.SH. Rrugë publike KK Prishtinë, sipas gjendjes faktike rrugë e asfaltuar dhe e frekuentuar, dhe e cila nuk është pjesë e trajtimit me këto kushte.

Sipërfaqja e parcelës ndërtimore trajtuar me këtë grup – fazë, brenda vijës rregulluese është $S=865m^2$, dhe jashtë vijës rregulluese-pjesa e parcelës nr.5879-0 ZK Prishtinë, me $S=112m^2$, sipas Planit të situacionit – "zgjidhjes urbane";

c) "Grupi - faza 3" e realizimit në kuadër të parcelës ndërtimore të konceptuar në bllokun urban "T20" të planit rregullues, për realizimin e kompleksit me ndërtesë shumë banesore & afariste – Lam. "03", analizuar, studiuar & konceptuar me këtë fazë, bazuar në evidencën kadastrale formohet nga pjesët dhe parcelat kadastrale, nr.5872-0, 5873-0, 5874-0, 5875-0 dhe 5877-0 ZK Prishtinë, me pronar dhe bashkëpronarë, Safet Talla, Snežana Ilić, Behadin dhe Berkan Stanovci dhe P.SH. KK Prishtinë.

Në këtë pjesë të sipas planit rregullues shtrihet edhe pjesa e parcelës nr.7714-0 ZK Prishtinë, me pronar / posedues P.SH. Rrugë publike KK Prishtinë, sipas gjendjes faktike rrugë e asfaltuar dhe e frekuentuar, dhe e cila nuk është pjesë e trajtimit me këto kushte për arsyet e theksuara.

Sipërfaqja e parcelës ndërtimore-brenda vijës rregulluese, analizuar me këtë grup – fazë është $S=565m^2$, kurse pjesa jashtë vijës rregulluese është $S=505 + 121=626m^2$. Bazuar në Vendimin e Kryetarit të Komunës së Prishtinës 01 nr.400-660 dt. 26.05.2008, sipërfaqja e parcelave mund të trajtohet brenda bllokut urban, deri në 20% të parcelës ndërtimore, dhe sipas kalkulimit kjo sipërfaqe do të jetë, $S=565 \times 0.2(20\%)=113m^2$, gjithmonë duke u bazuar në analizën dhe studimin me Plani i situacionit – “zgjdhja urbane”.

Pasi parcelat kadastrale, nr.5873-0 me $S=170 m^2$ dhe nr.5874-0 me $S=81 m^2$, janë me posedues / pronar, P.SH. KK Prishtinë, dhe shtrihen Brenda bllokut urban “T20”, bazuar në Ligjin Nr. 04/L-144 dt. 22.11.2012, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, të njëjtat mund të këmben me pjesë të parcelave, nr.5877-0 me $S=505m^2$ dhe nr.5872-0 me $S=121 m^2$, të përfshira jashtë vijës rregulluese, bazuar në vlerësimin e organit kompetent.

Me kalkulimet edhe përqindjen e mbetur nga parcela ndërtimore të “Grupi – faza 1” dhe “Grupi – faza 2”, të trajtuara si një tërësi, $S=843 + 900=1743m^2$, dhe duke llogaritur 20% të këtyre parcelave, $S=1743 \times 0.2(20\%)=348.60m^2$, si dhe faktit se për parcelat ndërtimore të potencuara janë trajtuar sipërfaqet, $S=152 + 112=264m^2$, për trajtim mbetet edhe sipërfaqja $S=348.6 - 264=84.60m^2$.

Andaj, sipas këtyre analizave, mund të konkludohet se në “Grupi – faza 3”, nga sipërfaqja e gjithmbarshëm e parcelave kadastrale, mund të trajtohet sipërfaqja prej: $S=565+113+84.60=762.60m^2$, kurse pa u trajtuar mbetet sipërfaqja prej $S=177.40m^2$ që përfshihet në Bllokun urban “T21” dhe rrugët e planifikuara.

Bazuar në analizën e Plani i situacionit – “zgjdhja urbane” për këtë grup – fazë, për realizimin e këtij grupi – faze, planifikohet edhe ri rregullimi i kufijve të parcelave ndërtimore, gjegjësisht parcelës kadastrale, nr.5879- 0 dhe 5877-0 ZK Prishtinë, me sipërfaqe prej $S=39m^2$ dhe parcelës nr.5876-0 ZK Prishtinë, gjithashtu me $S=39m^2$, sipas planit të situacionit dhe manualit të rregullimit të kufijve të parcelave ndërtimore, si dhe shtrirjes së rrugës për qasje në kompleks edhe në pjesën e “Grupi – faza 3”.

Me këtë ri rregullim, sipërfaqja e parcelave ndërtimore mbetet e njëjtë, vetëm se do të rregullohen parcelat ndërtimore dhe shtrirja-pozicionimi i ndërtesave në kuadër të tyre.

Për realizimin e “Grupi – faza 3”, pronarët e parcelave dhe investitori do të aplikojnë me kërkesë të veçantë për caktimin e kushteve ndërtimore, duke u mbështetur edhe në analizën dhe studimin me Plani i situacionit – “zgjdhja urbane”, në afatin dhe sipas kushtit të përcaktuar në paragrafin XIV. të këtij vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore.

V. Kushtet ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektin kryesor për rregullimin e hapësirës sipas gjendjes së planifikuar për realizimin/ndërtimin e kompleksit me ndërtesa shumë banesore & afariste – Lam. “01” & “02”, si dhe hapësirat përcjellëse, në kuadër të parcelave ndërtimore të Bllokut urban “T20” të Planit Rregullues “Tophane”, sipas kriterëve dhe parametrave urban, do të jenë:

- Organizimi, gabaritet, pozicionimi, etazhitetet e ndërtesave dhe raporti i tyre me distancat nga kufiri i parcelave, rrugët e planifikuara brenda bllokut, parcela ndërtimore e bllokut urban, si dhe kushtet tjera, të jenë në tërësi sipas prezantimit grafik të përshkruar në Plani i situacionit – “zgjdhja urbane”, bashkëngjitur vendimit të kushteve ndërtimore;

- Pjesët dhe parcelat kadastrale, me sipërfaqe të trajtuara, për realizimin e kompleksit me ndërtesë shumë banesore & afariste – Lam. “01” & “02”, konkretisht parcela të përfshira në ndërtim – brenda vijës rregulluese, janë:

- nr. 10087-1; $S=1240m^2$; / “Grupi - faza 1” dhe “Grupi - faza 2”/
- nr. 5876-0; $S= 269m^2$; / “Grupi - faza 2”/
- nr. 5879-0; $S= 234m^2$; / “Grupi - faza 1”/

Totali $S=1743m^2$

- Pjesët dhe parcelat kadastrale me sipërfaqe të trajtuara, për realizimin e kompleksit me ndërtesë shumë banesore & afariste – Lam. “01” & “02”, që shtrihen në hapësira publike të planifikuara, konkretisht që shtrihen jashtë vijës rregulluese, janë:

- nr.10087-2; $S=152m^2$; Kompensuar me “Marrëveshje” 010nr.465-143723 dt.23.06.2014/ “Grupi-faza 1”/

- nr. 5879-0; S=112m²; / "Grupi – faza 2"/

Totali: S=264m²

• Me këto kushte ndërtimore në kuadër të komplekseve, planifikohet ndërtimi i ndërtesave shumë banesore & afariste – Lam. "01" & "02", me sipërfaqe ndërtimore dhe etazhitet (sipas projekt propozimit), si në vijim:

Ndërtesa shumë banesore & afariste – Lam. "01" & "02",

Lam. "01" - S=5516m² /4120m², mbi tokë + 1396m², nën tokë /,

Etazhitet: -2B + P + 9

Lam. "02" - S=5264m² / 3908m², mbi tokë + 1356m², nën tokë /,

Etazhitet: -2B + P + 11

Totali Lam."1", "2": S=10780m² / 8028m², mbi tokë + 2752m², nën tokë /

• Destinimi i shfrytëzimit të ndërtesës të jetë "Ndërtim i lartë mix.", gjegjësisht banim shumë banesor & afarizëm, dhe me hapësira përcjellëse, si: kthina teknike, depo, dhe hapësira garazhuese (sipas projekt propozimit të prezantuar);

• Koeficienti i shfrytëzimit i parcelave të bashkuara në kompleks (ISHP), brenda vijës rregulluese, për vendosjen e ndërtesës në bazë - gabarit të përdhësës ose suteranit, lejohet max.40%, dhe kjo sipërfaqe është:

S= 878 x 0.4=351.20m² / "Grupi-faza 1" - lejuar sipas planit rregullues /,

S= 865 x 0.4=346m² / "Grupi-faza 2" - lejuar sipas planit rregullues /,

S= 685m² /sipas projekt propozimit për dy fazat/.

• Koeficienti i shfrytëzimit të parcelave ndërtimore të kompleksit për nëntokë (ISHPN) për vendosjen e ndërtesës në bazë - gabarit të bodrumit, lejohet max. 60% dhe bazuar në paragrafin II. pika 1. të Vendimit 01nr.031–185481 dt. 14.08.2015, të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, këto sipërfaqe janë:

S=878 x 0.6= 526.80m² / "Grupi-faza 1" - lejuar sipas planit rregullues /,

S=865 x 0.6 =519m² / "Grupi-faza 2" - lejuar sipas planit rregullues /,

S=1045m² / sipas projekt propozimit për dy fazat /.

• Në kuadër të parcelave ndërtimore, të planifikohen sipërfaqe gjelbëruese (me gjelbërim të lartë dhe të ultë) dhe absorbuese min.30%, bazuar në paragrafin II. pika 1. të Vendimit 01nr.031–185481 dt.14.08.2015, të Kryetarit të Komunës së Prishtinës dhe organizuar për sport dhe rekreacion, sipas planit të situacionit dhe normat teknike të planifikimit hapësinor, ku sipërfaqet për parcela ndërtimore, janë:

S=878 x 0.3=263.40m² / "Grupi-faza 1" - lejuar sipas planit rregullues /,

S=865 x 0.3=259.50m² / "Grupi-faza 2" - lejuar sipas planit rregullues /,

S=534.70m² / sipas projekt propozimit për dy fazat /.

• Koeficienti i ndërtimit (ISHN) bazuar në sipërfaqet e parcelave ndërtimore dhe "Kriteret bazë" të Vendimit 01 nr. 35–374 dt. 03.04.2008, lejohet të jetë max.4.0.

Trajtimi i sipërfaqeve ndërtimore për etazhet ndërtimore do të bëhet – llogaritet, si në vijim: **100%** për etazhet mbi kuotën ±0.00, **50%** për etazhet me vëllim mbi **51%** apo së paku njëra ballore mbi nivelin e tokës - **suteren**, dhe **0%** për etazhet e nëntokës – **bodrum**, dhe kjo sipërfaqe është:

S=878 x 4.0=3512m² / "Grupi-faza 1" - lejuar sipas planit rregullues /,

S=865 x 4.0=3460m² / "Grupi-faza 2" - lejuar sipas planit rregullues /,

S= 8028m² / sipas projekt propozimit për dy fazat /.

• Me aplikimin e Vendimit 01nr.400-660 dt.26.05.2008, të Kryetarit të Komunës së Prishtinës për kompensimin e pronës private për interes publik me sipërfaqe ndërtimore, sipërfaqja jashtë vijës rregulluese S=264m², nga parcela nr. 5879-0 dhe 10087-2 ZK Prishtinë, e trajtuar në kompleks, mund të kompensohet me sipërfaqe ndërtimore për sipërfaqet deri 20% të parcelës ndërtimore, dhe sipas kësaj, kjo sipërfaqe, përcaktuar në përqindje (%), është S=264 / 1743 x 100=15.14%. Me "Marrëveshje" 010nr.465-143723 dt.23.06.2014, sipërfaqja S=152m², e parcelës 10087-2, është kompensuar / shpronësuar me sipërfaqe ndërtimore, sipas kalkulimit, S=152 x 4.0=608m², ndërsa mbetet për kompensim-shpronësim edhe sipërfaqja prej S=112m², e parcelës 5879-0, me koeficient ndërtimi 4.0, dhe sipas kalkulimeve përcaktohet sipërfaqja ndërtimore, S=112 x 4.0=448m².

Bazuar në kalkulimet e lartcekura sipërfaqja totale e lejuar ndërtimore për ndërtesat shumë banesore & afariste - Lam."01" & "02": $S=3512 + 3460 + 608 + 448=8028m^2$;

- Bazuar në kriteret e planit rregullues, në zonat e reja të banimit, ruhet distanca në mes ndërtesave $0.3 \times H$. Te fasadat pa ndriçim primar, distanca është min. 3.0m nga kufiri i parcelës, kurse me pëlqim të vërtetuar, kjo distancë mund të zvogëlohet ose të ndërtohet në kufi;
- Etazhiteti maksimal i lejuar në Bllokun urban "T20" është i pa kufizuar;
- Bazuar në nenin III. të Vendimit të Kryetarit të Komunës së Prishtinës dt.14.08.2015, protokolluar me numrin 01nr.031-185481, për arsye të kursimit dhe efijencës së energjisë, sipërfaqja që zë shtresa e "termoizolimit" në fasadat e ndërtesës, nuk do të përfshihet në kalkulimin e sipërfaqes së përgjithshme ndërtimore (ISHN), e as në kalkulimin për taksën dhe tarifën e lejes ndërtimore;
- Ngritja e nivelit të përdhesisë së ndërtesës nga niveli i terrenit - trotuarit, lejohet të jetë max.1.2m;
- Qasja në kompleks të jetë nga rruga e brendshme e bllokut e lidhur me rrugën e planifikuar të planit rregullues urban, gjegjësisht nga rruga ekzistuese, e cila rrugë lidhet me rrugën e planifikuar;
- Në kuadër të kompleksit të parashihen edhe vend parkimet e jashtme, shtigjet, trotualet, kënde të lojërave për fëmijë, terrene sportive, mobiluar urban, etj.;
- Për çdo njësi banesore të planifikohet një vendparkim, kurse për pjesët afariste të ndërtesës varësisht prej destinimit të parashihen vend parkimet, për çdo $40m^2/1$ vend parkim;
- Në kuadër të kompleksit të planifikohen hapësira-pika për grumbullimin dhe vendosjen e mbeturinave;
- Arkitektura - dukja e jashtme (fasada) e ndërtesave dhe materializimi i tyre të jetë me materiale bashkëkohore dhe masa të efijencës së energjisë, dhe ti përshtatet ambientit për rreth;
- Si dhe aplikimi i të gjithave kushteve tjera urbane & arkitektonike të përcaktuara në kriteret & parametrat urban të Planit Rregullues "Tophane".

VI. Kompensimi / shpronësimi me sipërfaqe ndërtimore i pjesës së parcelës, nr.5879-0 me $S=112m^2$, e përfshirë në hapësira publike të planifikuara – rrugë, të realizohet si më poshtë:

Sipas kalkulimeve në paragrafin V., parcelat ndërtimore të komplekseve me ndërtesa shumë banesore & afariste, në kuadër të Bllokut urban "T20", është $S=1743m^2$. Andaj, bazuar në Vendimin e Kryetarit të Komunës së Prishtinës 01 nr.400-660 dt. 26.05.2008, kompensimi i pronës private të përfshirë në hapësira me interes publik, mund të realizohet me sipërfaqe ndërtimore për parcelat apo pjesët e parcelave me sipërfaqe deri 20% të parcelës ndërtimore, andaj sipas kësaj, kjo sipërfaqe e shprehur në përqindje (%) është $S=112+152 / 1743 \times 100 = 15.14\%$, e cila sipërfaqe mund të kompensohet në tërësi.

Me "Marrëveshje" 010nr.465-143723 dt.23.06.2014, parcela nr.10087-2 ZK Prishtinë (numër i ndryshuar pas bashkimit dhe ndarjes së parcelave bazë) është kompensuar / shpronësuar me sipërfaqe ndërtimore $S=152 \times 4.0=608m^2$, e cila sipërfaqe është pjesë e trajtimit me këto kushte ndërtimore. Andaj, sipas këtij kalkulimi, pronari / investitori për parcelën me $S=112m^2$, kompensohen me sipërfaqe ndërtimore: $S=112 \times 4.0=448m^2$, e cila sipërfaqe do të shfrytëzohet në "Grupi – faza 1", gjegjësisht në Lam."01";

Andaj, kjo drejtori jep PËLQIM për kompensimin / shpronësimin me sipërfaqe ndërtimore të pjesës së parcelës nr.5879-0 ZK Prishtinë, bazuar në vendimin e lartcekur. Kjo procedurë e kompensimit / shpronësimin me koeficient të ndërtimi, do të realizohet bazuar në pëlqimin e konfirmuar në këtë paragraf, e i cili do të shërbejë si bazë për arritjen e marrëveshjes definitive, në mes të pronarit të parcelës dhe Komunës së Prishtinës, konkretisht Drejtorisë së Pronës të Komunës së Prishtinës.

Mos zbatimi i kësaj procedure sipas këtij paragrafit, nga pronari, për arsye të ndryshme, obligon Drejtorinë e Urbanizmit, të rishikojë sipërfaqet ndërtimore të ndërtesës shumë banesore & afariste-Lam."02", të përcaktuara me këtë vendimin për caktimin e kushteve ndërtimore.

VII. Ndarja / parcelimi i parcelës kadastrale, nr.5879-0 ZK Prishtinë, do të realizohet sipas parcelës ndërtimore, të përcaktuar me vijën rregulluese me rrugët e planifikuara të planit rregullues urban, bazuar në Plani i situacionit – "zgjidhja urbane", dispozitës urbanistike punuar nga kjo drejtori dhe Manualit për ndarje.

Andaj, kjo drejtori jep PËLQIM për ndarjen e parcelës kadastrale të lartcekur, sipas Planit të situacionit - "zgjidhja urbane", "Situacioni i parcelave me vijën ndërtimore dhe rregulluese nga plani rregullues në sistemin koordinativ KosovaREF01", punuar nga kjo drejtori dhe Manuali i ndarjes, punuar nga kompania gjeodezike "Geo-Group"sh.p.k nga Prishtina. Procedura e ndarjes / parcelimit do të realizohet bazuar në pëlqimin e konfirmuar në këtë paragraf, e i cili do të shërbejë si bazë për evidentimin në regjistrin kadastral, të këtij ndryshimi.

Procedura e ndarjes të bëhet para aplikimit për leje ndërtimore, në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, sipas këtyre kushteve ndërtimore dhe me kërkesë të pronarit, duke u bazuar në, Plani i situacionit - "zgjidhja urbane", "Situacioni i parcelave me vijën ndërtimore dhe rregulluese nga plani rregullues në sistemin koordinativ KosovaREF01", punuar nga kjo drejtori dhe Manualit për ndarje, punuar nga Kompania gjeodezike e licencuar "Geo-Group"sh.p.k nga Prishtina me licencë nr.52, e i cili është pjesë përbërëse e këtij vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore.

VIII. Bashkimi i pjesëve dhe parcelave, nr.10087-1,5876-0 & 5879-0 ZK Prishtinë, do të realizohet sipas parcelës ndërtimore, bazuar në Plani i situacionit – "zgjidhja urbane", Situacioni i parcelës ndërtimore me vijën rregulluese dhe ndërtimore nga PRR "Tophane" në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01 dhe Manualit të bashkimit të parcelave.

Andaj, kjo drejtori jep PËLQIM për bashkimin e parcelave kadastrale të lartcekura, sipas Planit të situacionit - "zgjidhja urbane", Situacioni i parcelës ndërtimore me vijën rregulluese dhe ndërtimore nga PRR "Tophane" në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01 dhe Manualit për bashkim, punuar nga Kompania gjeodezike e licencuar "Geo-Group"sh.p.k nga Prishtina. Procedura e bashkimit do të realizohet bazuar në pëlqimin e përshkruar në këtë paragraf, e i cili do të shërbejë si bazë për regjistrimin në operetën kadastrale, të këtyre ndryshimeve.

Bashkimi të realizohet para aplikimit për leje ndërtimore në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, bazuar në kushtet ndërtimore, me kërkesë të pronarëve.

IX. Kyçja në infrastrukturë - për marrjen e pëlqimeve nga KEDS-i dhe KUR "Prishtina" aplikimi do të bëhet nga kjo drejtori. Për aplikim nevojitet prezantimi i dokumentacionit, me përcaktim të vendeve për kyçje në rrjetet përkatëse, i dorëzuar veçantë në CD, me përmbajtje si në vijim:

- Emri (prindi) Mbiemri i aplikuesit dhe numri i identifikimit dhe adresa;
- Informatën mbi lokacionin - adresa e saktë e hapësirës ndërtuese;
- Kopjen e planit dhe certifikatën e njësisë kadastrale;
- Planin e situacionit (dispozita urbanistike pjesë përbërëse e kushteve ndërtimore) dhe pamjen në ortofoto të lokacionit me hapësirën ndërtuese;
- Përshkrimin teknik të objektit (destinimi dhe kapaciteti i nevojshëm për energji elektrike dhe ujësjellës).

Kyçja në infrastrukturë për ngrohje qendrore të bëhet në rrjetin ekzistues, pas sigurimit paraprak të kushteve detale dhe pëlqimit për kyçje nga "Termokos" - Ngrohtorja e Qytetit sh. dhe PTK-ja.

X. Dokumentacioni ndërtimor / projekti kryesor, të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe me kualifikime përkatëse për secilën fazë të projektit, duke u bazuar në kushtet ndërtimore të caktuara në pikën IV., projekt propozimin e prezantuar, "Udhëzimit Administrativ i MMPH-së Nr.06/2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe II-të të ndërtimeve", "Udhëzimit Administrativ i MMPH-së Nr.08/2017 për normat teknike të planifikimit hapësinore", "Rregullores mbi normat minimale teknike për ndërtesat e banimit ne bashkëpronësi", të MMPH nr. 03/2016 dt. 04.11.2016, bazuar në UA nr. 33/2007 për kushtet teknike të objekteve ndërtimore për qasjen e personave me aftësi të kufizuara, normave teknike për siguri nga zjarri si dhe normave dhe standardeve tjera për projektim të kësaj kategorie të ndërtesave, dhe të përmbajë:

- Lokacionin e parcelës ndërtimore në kuadër të zonës;
- Situacionin - planin e lokacionit, të gjerë në diametër prej 50m, me ndërtesa ekzistuese dhe ndërtesat e planifikuara, në përpjesë 1:200, 1:500 apo 1:1000;
- Situacionin - planin e lokacionit 1:200 ose 1:500, me dimensione të shënuara, horizontale dhe vertikale-kuota të lartësisë;
- Situacionin - "zgjidhja urbane" në përpjesë 1:200 ose 1:500, me pozicionim të ndërtesave në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshi edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese, me kuota relative dhe absolute;
- Incizimin gjeodezik të parcelës ndërtimore me rrethinë, si dhe me pozicionim të ndërtesave të projektuara dhe infrastrukturës rrugore, në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01;

- Të gjitha bazat, prerjet dhe dukjet e fasadave, në përpjesë 1:50, për ndërtesat e projektuara, duke përfshi edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese dhe etazheve tjera me kuota të shënuara, relative dhe absolute;
- Përshkrimin teknik me paramasë dhe parallogari të punëve ndërtimore dhe ndërtimore - zejtare;
- Detajet e nevojshme në përpjesë 1:5, 1:10 apo 1:20 dhe specifikimin e zdrukthëtarisë me përshkrimin e materialit të dyerve dhe dritareve, në përpjesë 1:50;
- Projektin e organizimit të kompleksit, me rrugë, shtigje, mobiljarin urban, etj;
- Projektin e strukturës së ndërtimit - llogarinë statike, me përshkrim teknik, pozicionim dhe detaje të nevojshme;
- Projektin e instalimeve elektro – energjetike, me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetin energjetik të qytetit dhe pozicionimin e trafostacionit;
- Projektin e instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetin e qytetit;
- Projektin e instalimeve të makinerisë, me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetin e qytetit;
- Elaborati i "Organizmi dhe masat e sigurisë në vendndërtim", bazuar në Vendimin 01 nr. 035-174324 dt. 12.07.2016 e Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Elaboratin e fizikës ndërtimore dhe atë të mbrojtjes nga zhurma;
- Elaboratin gjeomekanik në bazë të analizave në terrenit;

XI. Dokumentacioni ndërtimor - Elaborati për Masat e mbrojtëse nga zjarri hartuar nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe kualifikim përkatës. Me aplikacionin për leje ndërtimore të dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm, në dosje të veçantë, i cili përmes aktit përcjellës, do të procedohet nga kjo drejtori në kompetencë të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit të Komunës së Prishtinës, për sigurimin e "Deklaratë" për Masat e mbrojtjes nga zjarri.

Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- Planin e mbrojtjes nga zjarri-elaboratin, të hartuar nga kompani apo individ i licencuar;
- Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale/certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit (kopje);
- Situacionin-planin e lokacionit, të gjerë në diametër prej 50m`, me ndërtesa ekzistuese dhe ndërtesat e planifikuara, në përpjesë 1:200, 1:500 apo 1:1000;
- Situacionin-"zgjidhja urbane" në përpjesë 1:200 ose 1:500, me pozicionim të ndërtesave në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshi edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese, me kuota relative dhe absolute;
- Kushtet ndërtimore, të caktuara nga Drejtoria e Urbanizmit (kopje);
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit të investitorit dhe të hartuesit të planit të mbrojtjes nga zjarri.

Dokumentacioni ndërtimor- Elaborati për Leje Mjedisore Komunale hartuar nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe kualifikim përkatës, dhe aplikimi të bëhet në Drejtorinë e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, njëkohësisht me aplikimin për leje ndërtimore.

Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- Raporti për Leje Mjedisore Komunale, në tre (3)kopje në formë të shkruar dhe një (1) në formë elektronike;
- Certifikatën për regjistrimin e biznesit;
- Certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit;

Kontratën për shfrytëzimin e parcelës, nëse parcela nuk është pronë e aplikuesit.

XII. Marrëveshja për infrastrukturë – bazuar në nenin 23 të Ligjit Nr.04/L-110 për Ndërtim dhe në nenin 10 dhe 11 të "Rregullore mbi Taksën administrative për dhënie e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës" 01 nr. 434/01–0094474/17 dt. 24.04.2017, obligohet Drejtoria e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave e Komunës së Prishtinës, të vlerësojë një ngarkesë për të rimbursuar koston për krijimin, përmirësimin, zgjerimin apo riparimin e infrastrukturës, dhe të arrijë marrëveshje për infrastrukturë me pronarin/investitorin. Me aplikacionin për leje ndërtimore të dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm, në dosje të veçantë, i cili përmes aktit përcjellës, do të procedohet, nga kjo drejtori, në kompetencë të Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave të Komunës së Prishtinës, për arritjen e kësaj marrëveshjeje. Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale/certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit (kopje);
- Vendimi për caktimin e kushtet ndërtimore, së bashku me situacionin e miratuar, të lëshuar nga kjo drejtori;
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit të kompanisë investuese;
- Kontratën për bashkë investim (nëse është prezantuar në kërkesën për leje ndërtimore);

- *Autorizimin për përfaqësim (nëse është prezantuar në kërkesën e lejes ndërtimore);*
- *Kopjen e letërnjoftimit të kërkuarit/ve (bashkëpronarëve të parcelëa-ve dhe investitorit);*

XIII. Pagesa e taksës për dhënien e lejes së ndërtimit dhe tarifa për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës, do të realizohet sipas “Rregullore mbi Taksën Administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës” 01Nr.434/01 – 0094474/17 dt.24.04.2017 dhe bazuar në dokumentacionin ndërtimor / projektin kryesor, si pjesë përbërëse e kërkesës për leje ndërtimore. Pagesa e taksës dhe tarifës, sipas këtij paragrafi, do të realizohet sipas afatit kohor të përcaktuar në paragrafin 4 të nenit 16 të UA të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017, pas marrjes së konfirmimit për pagesë.

Pagesa e taksës administrative do të llogaritet edhe për rrënimin e ndërtimeve ekzistuese në kuadër të parcelës kadastrale, bazuar në gjendjen ekzistuese, incizimin gjeodezik dhe projektin ideor të atyre ndërtimeve, me pagesën e taksës së përcaktuar në pikën 5.9 të nenit 5 të rregullores së lartcekur dhe vendimit për lejimin e rrënit.

XIV. Kushti për realizimin e Lam.”02” – do të bazohet në nenin 45 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-03, dt.21.06.2016, dhe me pajtim të pronarëve të parcelave kadastrale, nr.10087-1, 5876-0 & 5879-0 ZK Prishtinë, përcaktohet kushti i aplikimit për leje ndërtimi për ndërtesën shumë banesore & afariste - Lam.”02” të “Grupi - faza 2”, i cili kusht do të realizohet pas kalimit të afatit prej një vit, nga dita e nënshkrimit të këtij vendimi.

Ky afat ju mundëson pronarëve të parcelave, nr.5872-0, 5873-0, 5874-0, 5875-0 & 5877-0 ZK Prishtinë, që si të bashkuar, të aplikojnë për kushte ndërtimore, të bashkëngjiten në Plani i situacionit – “zgjidhja urbane” dhe bazuar në “Kriteret bazë” të Vendimit për plotësimin dhe mënyrën e realizimit të Planit Rregullues Urban “Tophane” 01 nr. 35–374 dt. 03.04.2008, të shfrytëzojnë kriteret e përcaktuara në pikën d. të këtij vendimi për caktim të kushteve ndërtimore.

Njëherë, poseduesit i Vendimit të kushteve ndërtimore, obligohen që para aplikimit me dokumentacion për leje ndërtimore, të arrijnë marrëveshje për bashkë investim, në mes tyre apo me një investitor tjetër potencial, si person i dytë.

XV. Vlefshmëria e vendimit të kushteve ndërtimore është një (1) vit, me mundësi të vazhdimit për një (1) vit tjetër, në rastet kur nuk ka ndërruar gjendja ekzistuese apo dokumenti i planifikimit hapësinor, me aplikim para skadimit të afatit të vlefshmërisë së tyre.

A r s y e t i m

Kërkuarit / bashkëpronarët, Jeton Nallbani, Adnan dhe Edmond Cërvadiku nga Prishtina, rr.”Perandori Dioklecian”p.n. dhe pronari, Halit Maloku nga Prishtina, rr.”Perandori Dioklecian”p.n, me kërkesën 05nr.350/02 – 0167059/18 dt.11.07.2018, kanë kërkuar nga kjo drejtori caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektin kryesor për ndërtimin e kompleksit me ndërtesa shumë banesore & afariste – Lam.”01” & “02”, në lokacionin e përkrahur në paragrafin I. të dispozitivit të vendimit të kushteve ndërtimore.

Me kërkesën për kushte ndërtimore 05nr.350/02 – 0167059/18 dt.11.07.2018, dhe në fazën e trajtimit të saj, dhe atyre në fazat paraprake, kërkuarit kanë prezantuar dhe është trajtuar ky dokumentacion:

- *Dëshmia mbi pronësinë për parcelat kadastrale, nr. 10087-1, 5876-0 & 5879-0 ZK Prishtinë dhe Certifikatat e njësisë kadastrale, P-71914059-10087-1, P-71914059-05876-0 & P-71914059-5879-0 ZK Prishtinë, lëshuar nga Drejtoria e Kadastrit e Komunës së Prishtinës;*
- *Projekt propozimi konceptual – “zgjidhja urbane”, punuar nga kompania projektuese “Toning”-A”sh.p.k. nga Prishtina, me certifikatë të regjistrimit 71234924;*
- *Fotot e lokacionit;*
- *“Njoftimi publik” i datës 13.07.2018 + 17.07.2018;*
- *Fotokopja e pa vërtetuar e “Informatë mbi kushtet e lokacionit të zgjedhjes urbane – arkitektonike të ngastrave nr.5880,5881 dhe 5882 në kuadër të bllokut urban “T20” nga Plani Rregullativ Tophane” , 05nr.350-14203 dt.13.06.2008, lëshuar nga Dretorati për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit;*
- *Fotokopja e letërnjoftimit të pronarëve të parcelave kadastrale;*
- *Vërtetimi mbi obligimet tatimore, në emër të Halit Maloku, nr.165154/18 dt.10.07.2018;*
- *Vërtetimi mbi obligimet tatimore, në emër të Jeton Nallbani, nr.163797/18 dt.09.07.2018;*
- *Vërtetimi mbi obligimet tatimore, në emër të Adnan Cërvadiku, nr.163797/18 dt.09.07.2018;*

- Vërtetimi mbi obligimet tatimore, në emër të Edmond Cërvadiku, nr.163797/18 dt.09.07.2018;
- Fotokopja e vërtetuar e "Deklaratë reciproke juridike" në mes të, Edmond Cërvadikut, Jeton Nallbanit, Adnan Cërvadikut dhe Jonus Malokut nga Prishtina, përpiluar te noter Sefadin Blakaj, M.A. me LRP.nr.12477/2017 dhe Ref.nr.2338/2017 dt.11.12.2017;
- Incizimi gjeodezik – Situacioni i terrenit në parcelat nr.10087-1, 05876-0, 05879-0 ZK Prishtinë, punuar nga kompania gjeodezike "Geo-Group"sh.p.k. nga Prishtina, me licencë nr.39;
- Fotokopja e pa vërtetuar e Lejes urbanistike 05nr.350-14203/1 dt.08.08.2008, lëshuar nga Drejtorati për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit;
- Fotokopja e pa vërtetuar e Vendimit të lejes ndërtimore 05nr.351-181443 dt.04.09.2014, lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit;
- Fotokopja e pa vërtetuar e Aktvendimit të lejes së rrënimt të ndërtesave ekzistuese 05nr.035 – 130626 dt.03.06.2014, lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit;
- Fotokopja e pa vërtetuar e Konkluzion mbi pezullimin e vendimit të lejes ndërtimore 05nr.070-102181 dt.14.05.2015, lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit;
- Fotokopja e pa vërtetuar e "Marrëveshje" 010nr.465 – 143723 dt.23.06.2014, e lidhur në mes të Adnan dhe Edmond Cërvadiku, Jeton Nallbani dhe Komuna e Prishtinës, përfaqësuar nga Drejtoria për Financa dhe Pronë;
- Fotokopja e pa vërtetuar e "Deklaratë nën betim", e Qazim Gashit nga Podujeva, përpiluar nga noter Sinan Visoka në Podujevë, me LRP.Nr. rendor 3460 / 2014;
- Fotokopja e pa vërtetuar e "Informim" 05nr.021/03 – 0154085/17 dt.06.07.2017, lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit;
- Fotokopja e fletë aplikacionit 05nr.021/03 – 0154085/2017 dt.28.06.2017;
- Fotokopja e pa vërtetuar e Vendim Nr.A-261/14 dt.06.05.2015, lëshuar nga Departamenti Ligjor i MMPH-së;
- Fotokopja e pa vërtetuar e Aktvendim A.nr.722/15 dt.07.06.2017, lëshuar nga Gjykata Themelore e Prishtinës;
- Fotokopja e pa vërtetuar e Aktvendim A.nr.722/15 dt.24.04.2015, lëshuar nga Gjykata Themelore e Prishtinës;
- Fotokopja e pa vërtetuar e Aktvendim C.nr.3006/17 dt.22.06.2018, lëshuar nga Gjykata Themelore e Prishtinës;
- Fotokopja e pa vërtetuar e "Informim lidhur me Vendimin e lejes ndërtimore 05nr.351 – 181443 dt.04.09.2014", të datës 25.05.2015, lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit;
- Fotokopja e pa vërtetuar e Vendimit të lejes ndërtimore 05nr.351/02- 0173662/17 dt.24.10.2017, lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit;
- Fotokopja e pa vërtetuar e Aktvendim i taksës administrative dhe tarifës 05nr.351/02 – 0173662/17dt.06.10.2017, lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit;
- Fotokopja e pa vërtetuar e Vendimit të Lejes Mjedisore Komunale 05nr.3521/10 – 0179774/17 dt.06.10.2017, lëshuar nga Sektori i Mjedisit i Drejtorisë për Planifikim Strategjik dhe Zhvillim të Qëndrueshëm;
- Fotokopja e pa vërtetuar e Aktvendim mbi caktimin e tarifës për leje mjedisore komunale 05nr.352/10 – 0179774/17 dt.04.10.2017, lëshuar nga Sektori i Mjedisit i Drejtorisë për Planifikim Strategjik dhe Zhvillim të Qëndrueshëm;
- Fotokopja e pa vërtetuar e Faturës në vlerë 8,604.10€, paguar në TEB Bank me datë 19.09.2017;
- Fotokopja e pa vërtetuar e Faturës në vlerë 60,848.86€, paguar në TEB Bank me datë 12.08.2014;
- Fotokopja e pa vërtetuar e Aktvendim mbi caktimin e taksës administrative dhe tarifës për densitet 05nr.351-181443 dt.08.08.2014, lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit;
- Fotokopja e pa vërtetuar e "Pëlqim paraprak" 05nr.350 – 312977 dt.04.06.2014, lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit;
- Fotokopja e pa vërtetuar e Vendim i lejes mjedisore komunale 01nr.501 – 189353/1 dt.01.09.2014, lëshuar nga Kryetari i Komunës;
- Fotokopja e pa vërtetuar e "Pëlqim" i Fevzi Ashimit, datës 14.07.2008, vërtetuar në Gjykatën Komunale të Prishtinës, Vr.Nr.5769/2008 dt.16.07.2008;
- Fotokopja e pa vërtetuar e "Pëlqim" i Orhan Dubovcit, datës 14.07.2008, vërtetuar në Gjykatën Komunale të Prishtinës, Vr.Nr.5770/2008 dt.16.07.2008;
- Fotokopja e pa vërtetuar e "Pëlqim për rregullimin e dokumentacionit teknik" nr.10108 dt.11.09.2017, lëshuar nga KEDS;
- Fotokopja e pa vërtetuar e "Pëlqim për rregullimin e dokumentacionit teknik" nr.7153 dt.26.06.2014, lëshuar nga KEDS;

- Fotokopja e pa vërtetuar e “Dhënia e kushteve teknike” nr.1553/1 dt.19.06.2014, lëshuar nga KUR “Prishtina”;
- Fotokopja e pa vërtetuar e “Dhënia e kushteve teknike” nr.180731 dt.20.09.2017, lëshuar nga KUR “Prishtina”;
- “Ftesë” e datës 06.09.2018, dërguar Safet Tallës, Snezana Ilic dhe Behadin dhe Berkan Stanovci;
- Manuali i ndarjes dhe bashkimit, punuar nga kompania gjeodezike “Geo-Group”sh.p.k. nga Prishtina, me numër të licencës nr.52.

Drejtoria e Urbanizmit, pas shqyrtimit të kërkesës për caktimin e kushteve ndërtimore, 05nr.350/02 – 0167059/18 dt.11.07.2018, dokumentacionit të prezantuar, konsultimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor për zonën, dosjet e lëndëve të trajtuara në fazat / periudhat paraprake për hapësirën, rregullativën ligjore në fuqi, nga aspekti i planifikimit, ndërtimit dhe procedurës së përgjithshme administrative, si dhe dokumenteve gjatë fazës së trajtimit të kërkesës administrative, në mënyrë kronologjike konstatoi se:

Parcelat kadastale, nr.10087-1, 5876-0 & 5879-0 ZK Prishtinë, me sipërfaqe totale prej $S=1855\text{m}^2$, përfshihen në kuadër të Bllokut urban “T20” dhe hapësirë publike të planifikuar të Planit Rregullues “Tophane” në Prishtinë, duke mos llogaritur edhe parcelën, nr.10087-2 ZK Prishtinë, me $S=152\text{m}^2$ (të cilës i është ndërruar numri bazë pas ndarjes dhe bashkimit të parcelave), e cila bazuar në “Marrëveshje” 010nr.465-143723 dt.23.06.2014, në mes të Komunës së Prishtinës dhe bashkëpronarëve, Jeton Nallbani, Adnan dhe Edmond Cërvadiku, është kompensuar / shpronësuar me sipërfaqe ndërtimore në procedurat paraprake, dhe nga pronësia private ka kaluar në pronësi P.SH. KK Prishtinë, dhe e cila trajtohet me këtë fazë të caktimit të kushteve ndërtimore, gjegjësisht në Lam.”01” të “Grupi – faza 1”.

Bazuar në dokumentacionet/dosjet e lëndëve nga arkivi i drejtorisë, të zhvilluara në fazat e mëhershme / paraprake, konstatohet se, Drejtoria e Urbanizmit, bazuar në kërkesën, 05nr.350 – 14203/1 dt.04.08.2008, të Jeton, Edmond dhe Adnan Cërvadikut, ka caktuar/lëshuar Leje urbanistike 05nr.350-14203/1 dt.08.08.2008, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektin kryesor për parcelat, nr.5880, 5881 dhe 5882 ZK Prishtinë.

Bazuar në kriteret urbane të përcaktuara në lejen urbanistike, dokumentet e planifikimit hapësinor për hapësirën dhe rregullativën ligjore, konkretisht pikën 1 të nenit 18 të Ligjit për Ndërtim Nr.04/L -110, bashkëpronarët Jeton, Edmond dhe Adnan Cërvadiku me kërkesën, 05nr.351–181443 dt.31.07.2014, dhe bashkëngjitjen e dokumentacionit përkatës për pajisje me leje ndërtimi, edhe janë pajis, bazuar në Vendimin 05nr.351-181443 dt.07.09.2014, është lejuar ndërtimi i ndërtesës – “Objekti 2”, ku paraprakisht, duke u mbështet në Vendimin e Kryetarit të Komunës së Prishtinës 01nr.400-660 dt. 26.05.2008, është arritur “Marrëveshje” 010nr.465-143723 dt.23.06.2014 me Komunën e Prishtinës, për kompensimin / shpronësimin me sipërfaqe ndërtimore të pjesës së parcelës nr.10087-1 ZK Prishtinë (tani parcela nr.10087-2 ZK Prishtinë), me $S=152\text{m}^2$. Pas këtyre procedurave dhe ankesës së parashtruar nga fqiu i bashkëpronarëve të lartcekur, me vendimin e Gjykatës Themelore të Prishtinës, leja ndërtimore është pezulluar, dhe bashkëpronarët kanë ndërprerë ndërtimin e filluar.

Pas procedurave të zhvilluara në organin e shkallë së dytë-MMPH dhe gjykatës kompetente – Gjykata Themelore në Prishtinë, dhe pas vendimeve pozitive nga këto organe, bashkëpronarët Jeton Nallbani, Adnan dhe Edmond Cërvadiku, me kërkesën, 05nr.351/02 – 0173662/17 dt.18.07.2017, sërish aplikojnë për leje ndërtimore, me dokumentacion përkatës dhe të kompletuar, ku pas trajtimit të dokumentacionit ndërtimor, dhe dokumenteve tjera të prezantuara, me Aktvendim 05nr.351/02-0173662/17 dt.06.10.2017, caktohet taksa administrative për leje ndërtimi dhe tarifa për ndikimet në rritje të densitetit infrastrukturor, dhe pas pagesës së taksës, të njëjtit pajisen me Vendimin e lejes ndërtimore 05nr.351/02 – 0173662/17 dt.24.10.2017.

Pas fillimit të punimeve nga bashkëpronarët, bazuar në lejen ndërtimore, fqiu i njëjtë sërish parashtron ankesë ndaj vendimit të lejes ndërtimore, të cilën ankesë kjo drejtori e përcjell në organin kompetent të shkallës së dytë – MMPH, dhe sipas pikës 1 të nenit 130 të LPPA N.05/L – 031 dt.21.06.2016, ankesa e parashtruar kundër një akti administrativ, pezullon pasojat juridike të aktit administrativ, i cili veprim pezullues edhe ka pasuar në Vendimin e lejes ndërtimore 05nr.351/02 – 0173662/17 dt.06.10.2017.

Pas këtyre zhvillimeve dhe dakordimit të përbashkët të bashkëpronarëve dhe të fqinjët për trajtim të përbashkët në zgjidhje urbane dhe leje ndërtimore, të njëjtit përmes kërkesës 05nr.350/02

– 0167059/18 dt.11.07.2018 dhe dokumentacionit të prezantuar, kërkojnë nga kjo drejtori caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektin kryesor për ndërtimin e ndërtesave shumë banesore & afariste, në kuadër të parcelave kadastrale, nr.10087-1, 5876-0 & 5879-0 ZK Prishtinë, me trajtim të sipërfaqes së parcelës kadastrale nr.10087-2 ZK Prishtinë, me pronar / posedues P.SH. KK Prishtinë, me sipërfaqe prej S=152m², e shpronësuar / kompensuar me koeficient ndërtimi me “Marrëveshje” 010nr.465-143723 dt.23.06.2014, e lidhur në mes të bashkëpronarëve dhe Komunës së Prishtinës.

Drejtoria e Urbanizmit, pas pranimit të kërkesës së lartcekur me projekt propozimin e prezantuar dhe duke u bazuar në rregullativën ligjore në fuqi, konkretisht nenin 18 të Ligjit për Ndërtim, Nr.04/L -110 dhe UA të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017, me datë 13.07.2018 ka vendosë “Njoftim publik” me projekt propozim, në vende të dukshme të lokacionit, në diametrin e dritës prej 50m’, për njoftimin dhe dhënien e mundësisë pronarëve dhe poseduesve të rrethinës dhe palëve të interesuara, për dhënien e komenteve, i cili njoftim ka qëndruar deri me datë 17.08.2018 (gabim është shënuar 17.07.2018), ku gjatë së cilës periudhë nuk kanë arritur komente në email adresat e vendosura në njoftimin publik, që konstatohet se drejtoria mund të vazhdojë me procedurat e përpunimit dhe caktimit të kushteve ndërtimore.

Pas analizimit të projekt propozimit me Planin e situacionit – “zgjidhja urbane” në raport edhe me parcelat tjera në kuadër të Bllokut urban “T20” të planit rregullues, u konstatua se parcelat në vazhdim të këtij blloku, gjegjësisht në pjesën veri lindore të saj, shtrihen edhe parcelat kadastrale nr.5872-0, 5873-0, 5874-0, 5875-0 dhe 5877-0 ZK Prishtinë, të cilat parcela e përmbyllin bllokun në atë pjesë dhe në kuadër të të cilave përfshihen ndërtesa individuale banimore edhe lokale afariste me etazhitet, P+0 & P+1, ku disa nga parcelat janë të pa ndërtuara, dhe të cilat me mos trajtim në këtë fazë, zgjidhja urbane e kësaj pjese të bllokut do të ishte jo gjithë përfshirëse (edhe pse kriteret e planit e mundësojnë), dhe pronarët e këtyre parcelave nuk do të mund të shfrytëzonin koeficientin maksimal të ndërtimit (4.0) sipas “Kriteret bazë” të klasifikimit të përshkruara në Vendimin për plotësimin dhe mënyrën e realizimit të Planit Rregullues Urban “Tophane” 01 nr. 35–374 dt. 03.04.2008, sepse sipërfaqja e këtyre parcelave brenda bllokut urban, të trajtuara si të veçanta, është S=565m². Andaj është kërkuar nga projektuesi i kërkuar që të analizojnë dhe studiojnë edhe këto parcela, sipas parametrave urban të planit rregullues, dhe të prezantojnë propozimin edhe për këto parcela, si dhe të njoftojë edhe pronarët e këtyre parcelave me projekt propozimin dhe të marrin deklarin e tyre lidhur me këtë çështje.

Pas hartimit dhe prezantimit të projekt propozimit, me trajtim edhe të parcelave fqinje, dhe prezantimit të bartësi i lëndës - zyrtari përgjegjës, drejtoria përmes “Ftesë” të datës 06.09.2018, ka ftuar pronarët dhe bashkëpronarët e parcelave të lartcekur, që me datë 11.09.2018 në ora 10.00h, të paraqiten në zyrat e drejtorisë, për prezantim dhe trajtim të Plani i situacionit - “zgjidhjes urbane” dhe të deklarohen për zgjidhjen. Në ditën dhe orën e përcaktuar në ftesa, është mbajtur takimi, ku përveç kërkuarve dhe projektuesit, ka marrë pjesë vetëm pronari dhe bashkëpronari i parcelave kadastrale, nr.5875-0, 5877-3 & 5877-1 ZK Prishtinë, me ç’rast edhe është mbajtur procesverbali, në të cilin janë shënuar konstatimet e këtij takimi. Në takim, i njëjti është njoftuar me kriteret e planit rregullues, përparësitë që i ofron përfshirje në zgjidhje urbane, si dhe është diskutuar projekt propozimi, duke kërkuar nga ai, që së bashku edhe me fqinjët, të trajtohen në zgjidhje urbane. I lartcekuri, është deklaruar pro zgjidhjes urbane, por, me kusht që, për parcelën nr.5877-0 ZK Prishtinë, të rregullohen çështjet pronësore juridike, pasi kjo parcelë bazuar në certifikatat e njësisë kadastrale, është e evidentuar në tri njësi kadastrale, nr.5877-1, 5877-2 dhe 5877-3 ZK Prishtinë, kurse në vektorët kadastral, ajo figuron si një parcelë me nr.5877-0 ZK Prishtinë. Bashkëpronarët e parcelës kadastrale nr.5872-0 ZK Prishtinë, dhe pronarja gjegjësisht bashkëpronarja e parcelës, nr.5877-1 & 5877-2 ZK Prishtinë, nuk janë paraqitur në takim edhe pse kjo e fundit, është ftuar përmes ftesës së pronarit Safet Talla, pasi drejtoria nuk ka poseduar adresën e saj.

Pas këtij takim dhe analizimit edhe njëherë të Plani i situacionit - “zgjidhja urbane”, në raport me planin rregullues dhe gjendjen faktike në terren, u konstatua se brenda bllokut urban përfshihet edhe pjesa e parcelës, nr.7714-0 ZK Prishtinë, me pronar / posedues P.SH. Rrugë Publike KK Prishtinë, me destinim rrugë e asfaltuar, e cila është njëra nga rrugët lidhëse të rrugës “UÇK” me lagjen “Tophane”, kurse sipas Planit Rregullues “Tophane” të njëjtën rrugë e ka planifikuar si zonë ndërtimore, gjegjësisht në kuadër të shiritit - zonës ndërtimore, me ndërtueshmëri 100%, kurse ky

plan rrugën e planifikuar e ka ç' vendosur - dislokuar nëpër parcelat, nr.5867-0, 5869-0, 5869-0, 5870 & 5871 ZK Prishtinë, në të cilat, sipas gjendjes ekzistuese, janë të ndërtuara ndërtesa afariste dhe shumë banesore, me etazhitete P+2 & P+4 dhe me shfrytëzim të parcelave mbi ~90%. Andaj, pas kësaj situate, u vendos që pozicionimi i ndërtesës – Lam."02" të "Grupi – faza 2" të bëhet në brendësi të bllokut urban, duke mos cenuar rrugën dhe trotuarin ekzistues, e cila rrugë, është arterie lidhëse e rrugës "UÇK" me Lagjen "Tophane", gjegjësisht ndërtimi të realizohet brenda parcelave, nr.10087-1 dhe 5876-0 ZK Prishtinë, duke shfrytëzuar edhe diskrecionin që ja përcakton rregullativa ligjore njësisë përgjegjëse-Drejtorisë së Urbanizmit, në aspektin e planifikimit urban – arkitektonik, dhe përcaktimit të kushteve dhe lejeve ndërtimore.

Bazuar në gjendjen ekzistuese të parcelave kadastrale nr.5887-0, 5886-0, 5885-4 dhe 10122-0 ZK Prishtinë, të cilat shtrihen brenda bllokut urban dhe ndërtimet që janë në kuadër të tyre si, si ndërtesa afariste, administrative dhe shumë banesore, me etazhitet P+7, P+5 dhe P+3 dhe me shfrytëzim të parcelave mbi 90%, dhe pëlqimet e bashkangjitura në kërkesë nga pronarët dhe autorizuesit e tyre, u vendos që të njëjtat mos të trajtohen me këtë fazë, edhe pse të njëjtit përmes "Njoftim publik" janë informuar lidhur me pretendimet e fqinjëve të tyre.

Pas konstatimeve të lartshënuara, në mbështetje të nenit 45 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L – 031 dt.21.06.2016, me pajtim të aplikuesve për caktim të këtyre kushteve ndërtimore, dhe mos deklarimit të të gjithë pronarëve të parcelave kadastrale, u vendos që pronarëve dhe bashkëpronarëve të parcelave, nr.5872-0, 5873-0, 5874-0, 5875-0 dhe 5877-0 ZK Prishtinë, tu jepet një afat shtesë prej një viti, nga dita e nënshkrimit të këtij vendimi për caktim të kushteve ndërtimore, për kyçje-përfshirje në Plani i situacionit – "zgjidhje urbane", duke u bashkuar dhe trajtuar këto parcela si parcelë ndërtimore "Grupi – faza 3", për realizimin e Lam."03" të analizuar dhe studiuar përmes këtyre kushteve ndërtimore, sipas procedurës së përshkruar në paragrafin XIV. të këtij vendimi të kushteve ndërtimore. Bazuar në kushtin e përcaktuar, pronarët e parcelave, nr.10087-1, 5876-0 dhe 5879-0 ZK Prishtinë, dhe poseduesit e kushteve ndërtimore, mund të aplikojnë për pajisje me leje ndërtimore për ndërtimin e ndërtesës shumë banesore & afariste - Lam. "02", pas kalimit të afatit të përcaktuar, bazuar në dokumentacionin ndërtimor dhe rregullativën ligjore në fuqi.

Në analizën e situacionit nga aspekti i komunikacionit dhe prezantuar në shkresën e zyrtarit për komunikacion, është përcaktuar rregullsia e kompleksit dhe kyçja e sajë nga aspekti i komunikacionit, si dhe janë përcaktuar masat që duhet të ndërmerren, për kyçje të kompleksit në rrugën e brendshme të bllokut dhe e njëjta me rrugën e planifikuar, dhe ndër të tjera konstatohet:

Pas shqimit të propozimit të situacionit të zgjidhjes urbane të Jeton Nallbani, Edmond dhe Adnan Cërvadiku dhe Halil Maloku, "Tophane", Prishtinë, lidhur me kërkesën për kushte ndërtimore të lëndës 05-350/02-0167059/18, të dt. 11.07.2018, kyçja për automjete në rrugë të planifikuar dhe hyrja e përkohshme nga rruga ekzistuese me qarkullim një kahor, njëra për hyrje dhe tjetra për dalje nga ndërtesa banesore – afariste për lamelën Lam. 01 me etazhitet 2B+P+9, duke marrë parasysh edhe inkorporimin e fazës së dytë dhe të tretë për ndërtesat e lamelave Lam. 02 dhe 03 ku kyçja do të jetë me qarkullim dy kahore vetëm në rrugë të planifikuar, mund të pranohet si e till. Në fazat e ardhshme të projektimit dhe realizimit të ndërtesave banesore me afarizëm për rampa dhe vend parkime, duhet të aplikohen kriteret sipas "Rregullores për Normat Teknike për Ndërtesat e Banimit në Bashkëpronësi", dhe të arrihen kushtet e shikueshmërisë horizontale dhe vertikale në lokacionin e kyçjes, respektivisht hyrje daljes nga rrugët. Gjerësia e rrugës kaluese me qarkullim dy kahor përgjatë hapësirave të vend parkimeve të jashtme dhe të brendshme në garazha, duhet të jetë minimum 5.5m. Ndryshime në rrugë të planifikuara sa i përket regjimit të trafikut me qëllim të favorizimit të ndërtesës banimore afariste nuk duhet të ketë. Kyçja duhet të harmonizohet dhe ti përshtatet profilit të rrugës së planifikuar edhe në kohën kur realizohet ajo.

Bazuar në konstatimet e më sipërme dhe dokumentacionin e shqyrtuar, rregullativën ligjore në fuqi, konkretisht nenin 18 të Ligjit për Ndërtim Nr. 04/L-110 dt. 31.05.2012, nenin 21 të Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr. 04/L-174 dt. 31.07.2013, nenin 13 të "Udhëzimi Administrativ i MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimimi për kategorinë e I-rë dhe II-të të ndërtimeve", Drejtoria e Urbanizmit, në fazën e shqyrtimit të kërkesës 05 nr. 350/02 – 0167059/18 dt.11.07.2018,

për caktimin e kushteve ndërtimore, ka konstatuar se kërkuessit kanë prezantuar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, se plani i situacionit - "zgjidhja urbane", i propozuar me projekt propozimin e ndërtesave, për përcaktimin e kushteve ndërtimore për parcelat kadastrale nr.10087-1, 5876-0 dhe 5879-0, me trajtim edhe të sipërfaqes ndërtimore të parcelës kadastrale, nr.10087-2 ZK Prishtinë, është në harmoni me destinimin dhe kriteret tjera të planit rregullues urban për atë hapësirë, si dhe në harmoni me rrethinën, andaj konstatohet se janë plotësuar të gjitha kriteret e parapara ligjore për caktimin e këtyre kushteve ndërtimore.

Nga sa u cek më lartë u vendos si në dispozitiv të vendimit të kushteve ndërtimore.

Shtojcë: Plani i situacioni - "zgjidhja urbane" e kompleksit me ndërtesë të planifikuar, Situacioni i parcelave me vijën rregulluese dhe ndërtimore nga Plani Rregullues, në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01 dhe Manuali për bashkim & ndarje, punuar nga kompania gjeodezike e licencuar "Geo-Group" sh.p.k nga Prishtina.

Udhëzimi juridik: Pala e pakënaqur me këtë vendim, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi. Bazuar në vlerësimet nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPH.

I dorëzohet: Kërkuessve, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, Drejtorisë së Pronës, kësaj Drejtorie, në dosje të lëndës 05nr.350/02 – 0167059/18 dt.11.07.2018 dhe Qendrës për shërbim me qytetarë.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR.350/02 – 0167059/18 DT. 17.10.2018**

Zyrtari:
Ergyn Hajredini

U.D. Udhëheqëse e Sektorit:
Mimoza Berisha Prestreshi






Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic Of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opstina Pristina - Municipality Of Prishtina



DREJTORIA E URBANIZMIT

SITUACIONI I PARCELAVE ME VIJEN NDERTIMORE DHE RREGULLUESE NGA PLANI RREGULLUES NE SISTEMIN KOORDINATIV KOSOVAREF01



Punoi:
Kushtrim Domaneku.

Nëshkrimi: _____

Prishtinë: 18.07.2018

Legjenda:

-  Vija Rregulluese sipas PRRU
-  Vija Ndërtimore sipas PRRU
-  Parcelat Kadastrale



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor / Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja / Ministry of Environment and Spatial Planning
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVA CADASTRAL AGENCY

Zyra kadastrale komunale / Opštinska katastarska kancelarija: Prishtinë

Nr. i njësisë kadastrale / Br. katastarske jedinice: 05879-0,05876-0,10087-1,

Zona kadastrale / Katastarska zona: Prishtinë


Numri i lëndës / Broj predmeta: /2018

Lloji i njësisë kadastrale / Vrsta katastarske jedinice: Parcelë

Shkalla e zvoglimit / Razmera plana: 1:500

Propozim për ndarje dhe bashkim të parcelave

Nr	Y	X
1	7513099.680	4725160.100
2	7513110.860	4725165.790



Rilevoi / Snimio: "Geo-Group" Sh.p.k.
(emri dhe mbiemri i gjeodetit/kompanisë/ ime i prezime geodeta/ kompanije)

Nr. i licencës / Br. licence: 52

Nënshkrimi / Potpis: 

Data e rilevimit / Datum snimanja: 08.10.2018



Aprovoi / Usvojio: _____
(emri dhe mbiemri i personit zyrtar/ ime i prezime sluzbenog lica)

Nënshkrimi / Potpis: _____

Data e aprovimit / Datum usvajanja: _____

